



| | | | |
|--|---|---------------------|--|
|  Republika e Kosovës Republika Kosovo | ZYRA E PERSONELIT KANCELARIJA OSOBLJA | |  Komuna e Istogut Opština Istok |
| | 02 Nr.199 /18 | Data: 05.10.2018 | |

Në bazë të nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 12, paragrafi 4, të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Komuna e Istogut nxjerr:

K O N K U R S

Për Kryerjen e punëve me marrëveshje për shërbime të veçanta

Drejtoria: Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

Titulli i vendit të punës: Zyrtar/e për Siguri të Përgjithshme

Lloji i pozitë: Marrëveshje për Shërbime të Veçanta (kohëzgjatja 6 muaj).

Numri i ekzekutuesve: 1 (një)

Numri i Referencës: 02N.199 /18

Orari i plotë: 40 orë në javë

Niveli i Pagesës: 400

Detyrat dhe Përgjegjësit:

1. Të përcjellë zhvillimet teknologjike nga sfera e sigurisë;
2. Planifikon dhe paraqet kërkesat për ndërmarrjen masave të sigurisë së përgjithshme në tërë teritorin e komunës;
3. Planifikimi dhe koordinimi i aktiviteteve me sektorin privat;
4. Nga lamia e sigurisë së përgjithshme, zbaton Ligjin, Rregulloret dhe Vendimet me të cilat rregullohet ajo çështje nga fushë-veprimi i saj;
5. Bashkërenditë aktivitetet në përgaditjen dhe jetësimin e masave që kanë të bëjnë me siguri të përgjithshme;
6. Në bashkëpunim me zyrtarët tjerë dhe oficerët e policisë harton planin për mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit të kamerave;
7. Ofron ndihmë profesionale organizatave shoqërore dhe private në hartimin e planeve të monitorimit të hapësirës me kamera;
8. Si dhe shërbime të tjera që rrjedhin nga natyra e sigurisë së përgjithshme të paraqitura nga mbikëqyrësi.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë konkurrimi në këtë pozitë kanë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

Kualifikimet e nevojshme:

- Diplomë e shkollës së mesme;
- Trajnime nga lamia e sigurisë;
- Një vitë përvojë pune në profesion.

Dokumentet:

- Dëshmi të kualifikimit shkollor;
- Dëshmi mbi përvojën e punës;
- Dy rekomandime;
- Dokument identifikimi;
- Certifikata e lindjes apo ekstrakti;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;

Afati i Konkurimit: Konkursi është i hapur pesëmbdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e publikimit.

Data e shpalljes së konkursit 05.10.2018 deri më datë 19.10.2018

Paraqitja e kërkesave : Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr.100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

"Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë"

- Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen



Menaxheri i Personelit
Fatmir Bytyçi